



ODA E NOTERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
NOTARSKA KOMORA REPUBLIKE KOSOVA /
NOTARY CHAMBER OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Këshilli Drejtues i Odës së Noterëve të Kosovës, në bazë të nenit 63 par. 2.4 të Ligjit Nr. 06/L-010, për Noterinë, nenit 19 par. 3.25 të Statutit të Odës së Noterëve, me datë 04.11.2020 bënë këtë:

**SHPALLJE PUBLIKE PËR SHPREHJE TË
INTERESIT**

Oda e Noterëve të Kosovës, bënë ftesë publike për palët e interesuara për dorëzimin e ofertave për hartimin e planit ideor dhe detal për objektin **“Selia e Odës së Noterëve”** në Prishtinë.

Oferta duhet të përfshijë, por pa u kufizuar në:

- Holli kryesor së bashku me shkallet
- Informatat -sigurimi
- Hapësirat për përkthim në 3 kabina
- Hapësira për konsultime për 10 deri 12 persona
- Salla me kapacitet 120-200 persona me mundësi zgjerimi.
- Zyre e Kryetarit, përfshi pjesën e takimeve dhe hapësirën e ndarë të asistentit
- 3 Zyre për 1 person
- Zyre për 4 persona
- Zyre për 8 persona e cila mund të përdoret dhe si sallë e mbledhjes
- Arkiva
- Nyjat sanitare për femra dhe për meshkuj, dhe hapësira për mirëmbajtje
- Gardëroba
- Bife për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm
- Kaldatorja me depon përkatëse

Objekti do të ndërtohet në parcelat nr. P-71914075-00410-3 dhe 00410-4, ZK Çagllavicë, sipërfaqe të përgjithshme prej 768m², në kate P+1.

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës është 40% ose sipërfaqja bruto e objektit në të gjitha etazhet, P+1 duhet të jetë maksimum 700 m².

Çmimi i ofertës duhet të jepet në m² ndaras për Planin ideor dhe ndaras për Planin detal.

Ofertat dhe dokumentet përcjellëse pranohen gjatë periudhës sa është e hapur shpallja publike, nga data 04 – 20 Nëntor 2020, nga ora 08:30-16:00 në selinë e ONK-së, adresë Rr. "Bashkim Fehmiu", OB-13-BL-A, C10, Hyrja 2, Kati i 4-të, banesa nr.21, Arbëri, Prishtinë, ose edhe në e-mailin: info@noteria-ks.org me kusht që secili dokument të jetë i nënshkruar.

Për çfarëdo informate shtesë, mund të kontaktoni në: +383/45 299 989 dhe 038/726 018, apo në e-mailin info@noteria-ks.org